

Nr. 24 prot

Dt. 28/12/2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 13, datë 24/12/2020

PËR
SHFUQIZIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR “PËR
ENERGJI ELEKTRIKE” ME OBJEKT “Hec Hidrocentrali 4”

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,nenit 41, nenit 50, nenit 51 dhe nenit 52, të ligjit 111/2012 datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”(i ndryshuar) dhe të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozim të Z.A.B.U. Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë.

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e Lejes Nr.5, datë 12.12.2011 “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE”, subjektit "Roen Company; Shansi Invest; Sigers; Archimed Internaci; Sina-98;", me objekt “Hidrocentrali 4”.
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

MAJLINDA ANGONI

